

## STATUT I SHOQERISE TREGTARE

### “MPED-XH GROUP” SH.P.K

Shoqeria tregtare “MPED-XH GROUP” SH.P.K krijohet ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “,ligjin129/2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te ndryshuar , dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

#### KREU I

#### Dispozita te pergjithshme

#### NENI I

Shoqeria “MPED-XH GROUP”SH.P.K eshte person juridik shqiptar.

Ajo gezon personalitetin juridik qe nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregtar dhe ne Organin tatimor.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e themelimit (Akti i Themelimit dhe Statuti )

#### NENI 2

Shoqeria “MPED-XH GROUP” SH.P.K eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me seli ne ne adresën :

**Elbasan, Lagjja Aqif Pasha, zk.8524, pallati nr.29/1, kati 2, ap N13.**



Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

### **NENI 3**

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj.

### **NENI 4**

Emertimi i shoqerise eshte **“MPED-XH GROUP” SH.P.K**

Ky emertim vendoset ne te gjitha letrat qe perdoren per korespondence ne faturat,ne te gjitha reklamat dhe botimet e nxjerra prej saj dhe do te pasohet nga fjala “ sh.p.k ” ose “ Shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar” nga numri i regjistrimit te saj dhe selia.

## **KREU II**

### **Objekti i veprimtarise**

### **NENI 5**

Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jete:

**Aktivitet ne fushen e ndertimeve. Punime te specializuara ne fushen e ndertimit. Ndermarje ndertimi per vete dhe per te trete ne kryerjen e veprimtarive ndertimore, ndertime civile, industriale, bujqesore, turistike dhe kompletimi me instalimet elektrike,hidraulike,...etj qe lidhen me to. Studim, projektim, ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar. Projektim, ndertim, montim, zbatim e rikonstruksion te: godinave te te gjitha llojeve, rruge te cdo kategorie, punime nentokesore, ura e vepra arti, ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, ndertime hidroteknike, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e binifikime, barriera dhe mbrojtje lumore, diga, damba, tunele. Ndertim impjante idrosanitare, kuzhina, lavanteri e mirembajtjen e tyre. Impjante ngritese transportuese. Ndertime parafabrikat beton arme, muratur, struktura metalike e druri. Impjante teknologjike, termike e kondicinimi. Impjante e linja telefonie dhe telekomunikacioni. Impjante te brendsheme lektrike, telefonike, radiotelefoni..etj. Impjante te sinjalistikes rrugore te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndricuese. Investime ne ndertime civile, pallate e ne ndertime turistike. Ndertimet dhe projektme inovative te cilat synojne te sigurojne kosto te ulet dhe cilesi te larte, ndertime ekologjike dhe eficente lidhur me ngrohjen dhe ftohjen e brendshme te**

ndertesave, qofshin ato per nevoja private apo publike. Ndertime duke perdorur material te reja te cilat jane profilet e metalit dhe llamarinat sanduic , profilet dhe matrialet e alumini dhe celiku te perpunuar ,ne modele dhe ngjyra te ndryshme, duke integruar gjetjet e tyre shkencore kryesisht ne sektorin e ndertimit te banesave, publike dhe private. Tregtimi I pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme. Projektim e konsulence teknike. Joint-veture. Germime. Transport per nevojat e aktivitetit. Transport rrugor kombetar e nderkombetar per vete, te trete e me qira. Tregti me shumice e pakice materiale ndertimi, hidraulike, elektrike, industriale,..etj. Import-eksport. Dhe cdo aktiviteti tjeter te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjislacionit Shqiptar.

#### NENI 6

Themeluesit e shoqerise rezervojn te drejten te modifikojne objektin e veprimtarise ne cdo kohe.

#### **KREU III**

*Kapitali themeltar*

#### NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte **100.000** leke shqiptare.

Ortaket:

1. **Znj.Olta Sharra zoteron nje kuote me vlere 50.000 leke ose 50 % te kapitalit themeltar.**  
**Z.Elbert Laskaj zoteron 1 kuote me vlere 50.000 ose 50% te kapitalit themeltar.**

#### KREU IV

#### NENI 8

Ortaket ushtrojn kompetencat qe i jane caktuar , ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " dhe ligjit 129/2014 . Ata marrin vendime per veprimtarine e shoqerise dhe politiken ekonomike e tregtare te saj .

#### **NENI 9**





Vendimet ne emer te ortakeve merren sipas parashikimeve te percaktuara ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise. Ortaket marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:

Miratojne strukturen organizative te shoqerise dhe numrin e vendeve te punes.

Emerojne dhe shkarkojne Administratorin e shoqerise.

Administrator i Shoqerise emerohet **Z.Laidon Laskaj** i pajisur me numer personal **I40516026I**, me kohezgjatje te mandatit per **5 vjet**.

Ndryshojne e modifikojne statutin e shoqerise , kapitalin themeltar e objektin veprimtarise se shoqerise , si dhe ndryshimin e formes juridike te shoqerise.

Miratojne llogarite pas raportit te eksperteve kontabel.

Vendosin per prishjen e shoqerise.

Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.

Riorganizimin , mbarimin dhe prishjen e shoqerise dhe likuidimin e saj .

Orientimet ne baze te te cilave do te drejtoje veprimet shoqeria , e do te caktojte preferencat e politikës se saj ekonomike e tregtare.

Ndermarrjen e aktiviteve te reja afariste .

Dhenien per peng ose hipoteke apo siguri tjeter te ngjashme.

#### NENI 10

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te shoqerise si dhe ato te percaktuara ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008 dhe ligjin 129/2014.

Ai ka te drejta te plota per drejtimin operativ te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha veprimet qe duhen per aktivitetin e shoqerise .

Administratori perfaqeson shoqerine ne te gjitha veprimet juridike e financiare te saj me pale te tjera , me banka,shoqeri transporti, e tjere.

Administratori mund te heqe dore ne cdo kohe nga detyra e tij, nepermjet nje njoftimi me shkrim drejtuar asamblese se ortakeve. Administratori qe jep doreheqjen , duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarise se shoqerise eshte gjithshu i detyruar te kerkoje nga asambleja e ortakeve te marre vendim per emerimin e administratorit te ri, perpara dates ne te cilen doreheqja te hyje ne fuqi.

Nese asambleja e ortakeve nuk vendos emerimin e administratorit te ri ne daten e percaktuar ne thirrjen e kryer nga administratori i dorehequr , atehere administratori njofton me shkrim doreheqjen Qendres Kombetare te Regjistrimit sebashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblese se ortakeve dhe Qendra Kombetare e regjistrimit regjistron largimin e administratorit sipas procedurave te ligjit 9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit te ndryshuar.

#### NENI 11



Ortakët emerohet deri në dy ekspertë kontabel për një periudhë kohe prej 6 vitesh  
financiare të cilët ushtrojnë kontroll të veprimtarisë së shoqërisë.  
Ekspertët kontabel bëjnë të gjitha verifikimet e kontrollet që gjykojnë të nevojshme, në  
çdo kohë të vitit dhe të dy bashkë ose veç e veç.

Ata mund të shqyrtojnë në vend të gjithë dokumentacionet e shoqërisë që e  
vlerësojnë të dobishme në ushtrimin e detyrës së tyre.

## **KREU V** **Veprimtaria e shoqërisë**

### **NENI 12**

Viti ekonomik financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.  
Viti i parë financiar fillon në datën e themelimit të shoqërisë.  
Pagimi i pagave, taksave e tatimeve dhe i kuotave për sigurimet shoqërore do të bëhet në  
përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi.

### **NENI 13**

Shoqëria do të mbajë librin e llogarive në lekë dhe në valute të huaja dhe do të bëjë  
përlogaritjet për nxjerrjen e bilancit në përputhje me ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004  
" Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### **NENI 14**

Emerimi dhe marrja në punë, caktimi i pages për çdo punonjës dhe largimi nga  
punë janë kompetencë e administratorit.

Mardhëniet e punës me shoqërisë si punëdhënëse dhe punëmaresve rregullohet me  
kontratat e punës dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **KREU VI** **Prishja , shpërndarja dhe likuidimi**

### **NENI 15**

Shoqëria mund të shpërndahet për shkakët e mëposhtme:

- a) Me vendim të asambleës së ortakëve.
- b) Me humbjen e gjysmës së kapitalit themeltar, pasi të jetë shpenzuar dhe fondi rezerve.

Ne rast se ortakët nuk marrin vendim për të plotësuar kapitalin ose zvogëluar atë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

d) në rast se objekti bëhet i përealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkak të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare.

e) në rastet e pavleshmërisë së themelimit të shoqërisë

Në rastin e prishjes së shoqërisë, shoqëria do të likuidohet.

Ortakët duhet të caktojnë një ose disa likuidatorë.

Likuidimi i shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit nr 129/2014..

#### **NENI 16**

Te pakten 15 dite përpara datës së aprovimit të llogarive të shoqërisë, këto llogari duhet të jenë në dispozicion të ortakëve në selinë e shoqërisë.

Administratori do të përcaktojë rregullat operative për t'i bërë të mundur ortakut konsultimin e librave të llogarive të shoqërisë te pakten 2 herë në vit.

#### **NENI 17**

Përsa nuk është e parashikuar nga statuti i tanishëm do të zbatohet legjislacioni në fuqi.

Date 15/06/2021

**STATUTI I SHOQËRISË "MPED-XH GROUP" SH.P.K.**

#### **ORTAKËT**

**Znj,Olta Sharra**

**Z.Elbert Laskaj**